

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“CAPOTRADE” sh.p.k

Tiranë më datë 26/10/2021

NENI 1

Shoqëria Tregtare “**CAPOTRADE**” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

NENI 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin **“CAPOTRADE” sh.p.k**

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive të ndërmjetësimit për të tretët, aktivitet në fushën e import-eksportit të pajisjeve të ndryshme.

Konkretnisht:

1. Ndërmjetësim për të tretët në lindhje me çështje tregtare
2. Import i pajisjeve të ndryshme
3. Eksport i pajisjeve të ndryshme
4. Në fushën e ndërtimit
5. Projektim i faciliteteve të ndryshme

Shoqëria mund të ushtrojë çdo lloj aktiviteti tregtar që legjislacioni i Republikës së Shqipërisë nuk e ndalon.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: **Ruga e Barrikadave; Qendra Turdiu; K2; N17, Tiranë, Shqipëri.**

NENI 5

Kapitali i Shoqërisë



Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën **100.000 (njëqind mijë) lekë**.

Kapitali ndahet në 1 (një) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

1. z. Maurizio Capoccetti, lindur më 28.01.1965, në Viterbo, Itali i Shtetësisë Italiane, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Kartës së Identitetit nr. CA27234CW, në cilësinë e ortakut themelues zoteron 100 % të vlerës së kapitalit themeltar, të barabartë me 1 (një) kuotë me vlerë **100.000 (njëqind mijë) Lekë**.

Kapitali themeltar është nënshkruar nga ortaku themelues në total. Vlerësimi dhe pagesa e kapitalit themeltar është nënshkruar nga Ortaku Themelues.

NENI 6

Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – Organi më i lartë vendimmarrës;
2. Administrator – Organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rigjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është **z. Maurizio Capoccetti**, lindur më 28.01.1965, në Viterbo, Itali i Shtetësisë Italiane, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nëpërmjet Kartës së Identitetit nr. CA27234CW, me një afat emërimi prej 5 (pesë) vitesh, afat që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8



Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit vit finanaciar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë. Shoqëria do të emërojë ekspertin kontabël.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqrissë, ngritura e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rretit Gjyqësor Tiranë.


NENI 13

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKU

Maurizio Capoccetti



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "MAURIZIO CAPOCCETTI". The signature is fluid and cursive, with the name written in a larger, more formal style above a smaller, more personal signature.